



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

44/91/51/2016

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

VENDIM

Nr. 467 datë 22/7/2016

**“PER DELEGIM KOMPETENCE PER AUTORIZIMIN E LEVIZJES SË ASETERVE
PËR DREJTORITE, DHE SEKTORET E BASHKISE SHKODER”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 64; ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 29; ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 5, 6, 35, 38; manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, dt. 15.07.2010;

VENDOSA:

- I. Delegimin e kompetencave, zv/kryetareve të Bashkisë Shkoder, për autorizimin e levizjes së asetëve për drejtorite, dhe sektoret e Bashkisë Shkoder sipas strukture, miratuar me vendimin nr.261 dt.11.05.2016 si më poshtë:

1. Zv/Kryetari z.Dritan Meta

- Drejtorja e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.
- Drejtorja e Kontrollit e Zhvillimit të Territorit
- Drejtorja e Shërbimit dhe Infrastruktura
- Drejtorja e Investimeve
- Njesia e Ofrimit Shërbimeve

2. Zv/Kryetari z.Fatbardh Sheqi

- Drejtorja e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit
- Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
- Sekretari i Keshillit Bashkiak
- Njesite administrative
- Gjendja civile
- Rajonet
- QKB

3. Zv/Kryetari z.Arben Gjuraj

- Drejtoria e Bujqësisë
- Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave

4. Zv/Kryetari zj.Emilja Koliqi

- Drejtoria e Analizes e Programimit Buxhetor
- Drejtoria Finances
- Drejtoria e Planifikimit dhe Regjistrimit të të Ardhurave

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkise Shkoder.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

